

VENDIM
Nr. 41, datë 10.3.2022

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGE KUÇ” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KUÇ”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1930 kw**

(ndryshuar me vendimin nr. 299, datë 18.11.2022; nr. 201, datë 23.6.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 322/4-1 prot., datë 8.3.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Age Kuç’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Kuç’, me kapacitet të instaluar 1930 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 239, datë 26.11.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AGE KUÇ” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE, me shkresën nr. 6/25 prot., datë 26.11.2021, kreu njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data 14.12.2021), nuk rezultoi të kishte komente apo objeksione prej tyre.

- ERE i është drejtuar shoqërisë, me shkresën nr. 1059/1 prot., datë 2.12.2021, me lëndë “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësimin e dokumentacionit të munguar në aplikim”.

- Në mbledhjen e Bordit, të datës 3.3.2022, në rendin e ditës ishte listuar, ndër të tjera, për shqyrtim relacioni me nr. 322/1 prot., datë 28.2.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Age Kuç’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Kuç’, me kapacitet të instaluar 1930 kw”.

- Duke qenë se nga shoqëria “Age Kuç” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 49/6 prot., datë 2.3.2022 u paraqit dokumentacion në lidhje me këtë praktikë, u vendos shtyrja e afatit procedural të vendimmarrjes përfundimtare të tij për licencimin e shoqërisë “Age Kuç” sh.p.k., në mënyrë që të shqyrtohej dokumentacioni i depozituar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Age Kuç” sh.p.k., në fazën përfundimtare të aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacionit për aplikim. Neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “m”, “e”, “f”, “g”. Plotësuar.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”. Plotësuar.
- Dokumentacioni teknik për HEC-in. Neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, germat: “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. Plotësuar.
- Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, germat: “a”, “b”. Plotësuar.
- Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me nenin 9, pika 4.1.5, germa “c”, “Leje nga institucione të tjera”, konstatohet se shoqëria “Age Kuç” sh.p.k., ka aplikuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM-së) në datën 1.3.2022, për t’u pajisur me VNM-në paraprake, në vijim të përfundimit të afatit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake të përcjellë më parë në këtë aplikim (VNM paraprake nr. 3326 prot., datë 3.7.2019, me nr. 688 identifikimi dhe nr. 38 vendimi, për personin juridik “Age Kuç” sh.p.k., për të zhvilluar projektin: “Ndërtim i HEC KUÇ”).
- Sa më sipër vlerësojmë që shoqërisë “Age Kuç” sh.p.k. t’i vendoset si kusht në dispozitiv depozitimi i VNM-së paraprake duke konsideruar afatin 45-ditor kalendarik që i nevojitet AKM-së për të lëshuar një VNM dhe kohën që i duhet shoqërisë për ta përcjellë në ERE këtë dokument. Afati maksimal që vlerësohet është 50 ditë kalendarike, i cili përkon me datën 19.4.2022.
- Brenda datës 3.10.2022, shoqëria “Age Kuç” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e shfrytëzimit të burimit ujor me afat të rinovuar.
- Me përfundimin e afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Himarë (për afatin 20-vjeçar, data e përfundimit 10.11.2041, llogaritur nga zbardhja e lejes së ndërtimit), do t’i kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afat të rinovuar, brenda datës 10.12.2041, apo të depozitojë çdo dokument tjetër që mund të disponojë për pronësinë e subjektit në zonën ku shtrihet projekti.
- Kontrata nr. 706 rep., nr. 317/3 kol., datë 5.4.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Kuç”, me kapacitet 1.930 mw, në rrjedhën e sipërme të pellgut ujëmbledhës të lumit të Shushicës, në afërsi të fshatit Kuç, Bashkia Himarë, qarku Vlorë”, lidhur midis Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë (MIE) dhe mbajtësit të miratimit, shoqërisë “Age Kuç” sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër, ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Age Kuç” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kuç”, me kapacitet të instaluar 1930 kw, për një afat 30-vjeçar.
2. *Shoqëria “Age Kuç” sh.p.k. të informojë ERE-n çdo 2 muaj mbi ecurinë e marrjes së lejes së rinovuar të përdorimit të burimit ujor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Kuç” dhe ta depozitojë atë në ERE , përpara fillimit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kuç”.*
3. *Shfuqizuar.*
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.
5. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me plotësimin/mosplotësimin e kushteve të cituara më sipër, e po ashtu në rast mosplotësimi të kushteve të licencës.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti